

KONTRATË SHITJE KUOTASH TË KAPITALIT TË SHOQËRISË "PENAMI"sh.p.k

Sot me datë 19 /01/2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), në Zyrën e noterisë Tiranë, me seli në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.7, Bulevardi: "Gjergj Fishta", Pall.6/1, Kati I-rë, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe përpara meje noteres **Elvira G. Alibali** u paraqitën personalisht palët kontraktuese:

Shoqëria "CFO PHARMA" shpk e rregjistruar në QKB me NIPT Nr. K22305002U, me seli në Mezez Kashar RRuga Pavaresia, ND. Nr.1, Tiranë, me ortak të vetëm dhe administrator **Nadir Çausholli**, atësia Fatos, datëlindja 14/02/1978, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, Njësia bashkiake Nr. 1 RRuga Gani Domi, Pall.1 Shk.3 Ap.46 shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr.personal **H80214054U**.

Prezent dhe dakort me shitjen bashkeshortja e tij **Arjola Çausholli**, atësia Guri, datëlindja 14.05.1986 lindur në Kamëz, Tiranë dhe banuese në Tiranë Njësia bashkiake Nr. 1 RRuga Gani Domi, Pall.1 Shk.3 Ap.46 shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr.personal **I65514098G**.

(këtu e më poshtë referuar si **Shitësi**)

1.Eduard Kapaj atësia Isuf, datëlindja 20/03/1970, lindur në Fier dhe banues në Fier Rajoni Nr.4, Lagja Vasil Jorgaqi, Pall.43, Shk.1 Ap.4, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identifikimit ID me Nr. **H00320236G**.

2.Almiro Gurakuqi, atësia Paulin, lindur me 27.12.1972, në Tiranë dhe banues në Tiranë, Njësia bashkiake Nr 7, Rruga:" Stavri Themeli", madhor me zotesi te plote jurdike per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin me nr. Personal **H21227034V**

(këtu e më poshtë referuar si **Blerësit**)

Baza Ligjore : Dispozitat e Kodit Civil

Ligji 9901 dt. 14.04.2008 « Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare »

Ligji 9723 dt. 03.05.2007 « Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit »

Kushtet paraprake

A) Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "PENAMI" Sh.p.k. është rregjistruar si person juridik me No. NIPTI **L82008017L**, me kapital themeltar 100,00 lekë, i zotëruar nga: **Almiro Gurakuqi**- 1 pjesë që përbën 30% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, me vlerë nominative 30,00 leke, Shoqëria "CFO PHARMA" shpk-1 pjesë që përbën 70% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, me vlerë nominative 70,00 leke, me administrator te shoqërisë **Erilda Selimi**, me seli në Tiranë Rruga Nikolla Lena, Kryqezimi i Rrugës Nikolla Lena me Rrugen e Kavajes, pallati i ri, 30 m poshte Kishes Ortodokse

B) Shitësi Shoqëria "CFO PHARMA" shpk ka vendosur të shesë një pjesë të **kuotave që disponon në kapitalin themeltar të Shoqërisë** dhe Blerësit janë të detyruar të paguajnë për to shumën e rënë dakort sipas kushteve dhe termave të kësaj Kontrate.

C) Të drejtat e pronësisë mbi kuotat e shitura kalojnë nga shitësi tek Blerësi në momentin e pagesës së plotë të çmimit të shitjes, moment që përputhet edhe me nënshkrimin e kësaj Kontrate nga Palët. Bashkë me të drejtat e pronësisë mbi Kuotat, Blerësit do të blejnë të drejtat e Pjesmarrjes në Shoqëri njëkohësisht edhe **detyrimet** që mbartin këto kuota bazuar në parashikimet e ligjit dhe aktet themeluese të Shoqërisë.

D) Palët duke marrë parasysh sa më sipër, pranojnë të lidhin këtë Kontratë shit-blerje të kuotave

(në vijim «Kontrata») sipas kushteve të mëposhtme :

Neni 1. Çmimi i kuotave dhe procedura e kryerjes së pagesës

1.1 Nëpërmjet kësaj Kontrate Shitësi "CFO PHARMA" Sh.p.k merr përsipër që nga 70% të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar të shoqërisë, të shesë 24 % të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë, e ndarë respektivisht:

- Blerësit **Eduard Kapaj** i shet dhe i transferon **11 %** të pjesëmarrjes, kundrejt **çmimit në total 11,00 lekë** ndërsa
- Blerësi **Almiro Gurakuqi** i shet dhe i transferon **13 %** të pjesëmarrjes, kundrejt **çmimit në total 13,00 lekë**.

1.2 Blerësi **Eduard Kapaj** pranon të blejë nga Shitësi "CFO PHARMA" Sh.p.k 11 % të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar të shoqërisë, kundrejt **çmimit në total 11,00 lekë**.

1.3 Blerësi **Almiro Gurakuqi** pranon të blejë nga Shitësi "CFO PHARMA" Sh.p.k 13 % të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar të shoqërisë, kundrejt **çmimit në total 13,00 lekë**.

1.4 Shitësi deklaron se çmimi i plotë i shitjes prej **24,00 lekë** është likuaduar i plotë nga ana e të dy blerësve.

1.5 Me nënshkrimin e kontratës dhe me likuidimin e plotë të çmimit të shitjes në total, kalon edhe pronësia e kuotave të shitura nga Shitësi "CFO PHARMA" Sh.p.k tek blerësit **Eduard Kapaj** dhe **Almiro Gurakuqi** duke u përbërë tashmë shoqëria "PENAMI" Sh.p.k nga ortaket:

1. Shoqëria "CFO PHARMA" shpk zotëruet i 1 pjesë, të barabarta me 46,00 përqind të kapitalit me vlerë **46,00 lekë**.
2. **Almiro Gurakuqi**, zotëruet i 1 pjesë, të barabarta me 43,00 përqind të kapitalit me vlerë **43,00 lekë**.
3. **Eduard Kapaj**, zotëruet i 1 pjesë, të barabarta me 11,00 përqind të kapitalit me vlerë **11,00 lekë**.

Neni 2. Deklarime dhe Garancitë e Shitësit

2.1 Shitësi deklaron dhe garanton se është bashkëpronarë dhe titullarë i ligjshëm të kuotave dhe i të drejtave që rrjedhin prej tyre.

2.2 Shitësi deklaron dhe garanton se kuotat janë të lira nga çdo peng, privilegj, barrë apo çdo e drejtë tjetër në favor të të tretëve, pa kufizime për tjetërsimin e tyre, kuotat nuk janë objekt i ndonjë mosmarrveshjeje, dhe nuk janë të pezulluara.

2.3 Shitësi deklaron dhe garanton se Shoqëria është themeluar dhe operon rregullisht në bazë të legjislacionit shqiptar dhe në bazë të akteve të shoqërisë, ka të drejtë të plotë për të ushtruar aktivitetin e saj në përputhje me aktin e themelimit dhe statutin që rregullon funksionimin e saj.

2.4 Shitësi deklaron dhe garanton se Shoqëria nuk është në proces falimentimi, likuidimi të vullnetshëm ose jo apo në ndonjë proces të ngjashëm.

Neni 3. Garancitë e Blerësit

3.1 Blerësit deklarojnë se e njohin statusin faktik dhe ligjor të Shoqërisë.

3.2 Blerësit e nënshkruajnë rregullisht këtë kontratë e cila është e vlefshme, e ligjshme dhe e detyrueshme për zbatim nga ana e Blerësve.


3.3 Blerësit kanë kryer të gjitha veprimet, kanë marrë të gjitha masat për përmbushjen e të gjitha detyrimeve sipas kësaj kontrate.



Neni 4 Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

4.1 Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrveshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj Kontrate.

4.2 Nëse nuk arrihet një zgjidhje me mirëkuptim, mosmarrveshja do të zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



Neni 5 E drejta e zbatueshme

5.1 Kjo kontratë dhe te drejtat e detyrimet e Palëve do të disiplinohen dhe ushtrohen në bazë të së drejtës shqiptare.


Neni 6 Vlefshmëria

6.1 Kjo kontratë është e vlefshme me nënshkrimin e saj nga palët. Kontrata hartohet në 4 (katër) originalë.


6.2 Palët pasi e pranuan sa është shkruar në Kontratë, e nënshkruan si më poshtë rezulton, një nga të cilat për ta paraqitur në QKB për të bërë të mundur regjistrimin e ndryshimeve përkatëse, një për Shitësit, një kopje për Blerësin, dhe një kopje për arshivën e noterit.

Palët


Shitësi
Shoqëria " CFO PHARMA" shpk
Ortak i vetëm dhe administrator
Nadir Çausholli


Nadir Çausholli
(emër, mbiemër, nënshkrim)

Prezent dhe dakort bashkëshortja
Arjola Çausholli


Arjola Çausholli
(emër, mbiemër, nënshkrim)

Blerësit
Eduard Kapaj


Almiro Gurakuqi





NOTERE

Elvira ALIBALI






V E N D I M
Nr 4, date 14/01/2019
I ASAMBLESE SE ORTAKËVE TË SHOQËRISË
"PENAMI" SHPK

Ne seline e shoqerise "PENAMI " sh.p.k, Asambleja e Ortakeve, me pjesmarrjen e Z. Nadir CAUSHOLLI, perfaqesues i kompanise "CFO PHARMA" Sh.p.k zoterues te 70 % dhe Almiro GURAKUQI zoterues i 30% te kapitalit te shoqerise "PENAMI" Sh.p.k me vlere 100,-leke, u moren ne shqyrtim ceshtjet e rendit te dites sa me poshte:

Rendi i dites:

1. Shitja e 11% e aksioneve te kapitalit te shoqerise "PENAMI" sh.p.k. nga "CFO PHARMA" sh.p.k. dhe blerja e tyre nga Eduart KAPAJ me ID 027964201 dhe numer personal H00320236G
2. Shitja e 13% e aksioneve te kapitalit te shoqerise "PENAMI" sh.p.k. nga "CFO PHARMA" sh.p.k. dhe blerja e tyre nga Almiro GURAKUQI me ID 028351505 dhe numer personal H21227034V

Ne perfundim te mbledhjes, ne zbatim te ligjit nr. 9901 date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ortaket pasi perpiluan verbalin e kesaj mbledhje,

VENDOSEN:

1. Shitja e aksioneve 11% te kapitalit me vlere 11 - leke te zoteruar nga Shoqeria "CFO PHARMA" Sh.p.k. dhe blerja e tyre nga Eduart KAPAJ.
2. Shitja e aksioneve 13% te kapitalit me vlere 13 - leke te zoteruar nga Shoqeria "CFO PHARMA" Sh.p.k. dhe blerja e tyre nga Almiro GURAKUQI.
3. Ky vendim merr fuqi nga dita e sotme, si dhe per permbajtjen e tij behen shenimet perkatese sipas ligjit si dhe kryhen regjistrimet dhe depozitimet e akteve ne QKR (Qendra Kombetare e Regjistrimit), me vullnetin e lire dhe te plote nenshkrhet nga Ortaket e Shoqerise "PENAMI" sh.p.k.



4. Kompania "PENAMI" sh.p.k. behet me 3 kuota dhe me 3 bashkepronar respektivisht: "CFO PHARMA" Sh.p.k. me 46% te kapitalit, Almiro GURAKUQI zoterues i 43% te kapitalit dhe Eduart KAPAJ zoterues i 11% te kapitalit.
5. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë që vete ose nëpërmjet një përfaqesuesi të autorizuar prej tij të veprojnë në emer dhe për llogari të shoqërisë për depozitim të këtij vendimi dhe akteve shoqëruese të tij pranë QKR-se

**ASAMBLEJA E ZAKONSHME E
SHOQËRISË "PENAMI" sh.p.k**

ORTAKET

CFO PHARMA

Walter Gaurth
[Signature]



Almiro Gurakuqi

Almiro Gurakuqi
[Signature]